

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES, FUNKSIONEVE DHE PROCEDURËS
SË KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NJOHJEN E
NJË PAKICE KOMBËTARE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, ka njohur pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë, ku aktualisht janë njohur 9 pakica kombëtare. Njohja formale e një pakice kombëtare, e ndryshme nga ajo e përcaktuar në këtë ligj, bëhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës pranë Ministrit të Brendshëm nga grupi i shtetasve i përbërë nga jo më pak se 300 persona, që pretendojnë se i përkasin një pakice kombëtare dhe shqyrtohet nga Komisioni ad hoc që ngrihet për këtë qëllim, sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij ligji, para se të bëhet njohja formale me ligj.

Në këto kushte, hartimi i këtij projektvendimi garanton të drejtën e një grupi shtetasish që pretendojnë se i përkasin një pakice kombëtare, të paraqesin një kërkesë për njohjen e tyre si pakicë kombëtare, pranë një Komisioni ad hoc, të ngritur për këtë qëllim, në përbërje të të cilit, përfaqësohen të gjitha institucionet, fusha e përgjegjësisë së të cilave lidhet me të drejtat e pakicave kombëtare.

Gjithashtu, në këtë projektvendim përcaktohet dhe procedura për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare nga personat e interesuar, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, afatet dhe e drejta e shtetasve që kanë paraqitur një kërkesë formale, që në rast refuzimi të kërkesës së tyre, të paraqesin ankim pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN

ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2019, por është në përputhje me politikat e qeverisë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim është hartuar në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe synon ngritjen, funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga grupi i shtetasve që pretendojnë se i përkasin një pakice kombëtare, përbërjen dhe përcaktimin e procedurave përkatëse.

Nisur nga fakti që Komisioni për shqyrtimin e kërkesës përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, është vlerësuar të ngrihet me urdhër të Kryeministrit.

Ngritja dhe funksionimi i Komisionit me përfaqësim nga të gjitha institucionet përgjegjëse, do të bëjë të mundur që brenda afateve të përcaktuara në këtë projektvendim të shqyrtohet kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues, të plotësohet dokumentacioni në rast mangësish dhe të merret një vendim i bazuar, pasi të vërtetohet përkatësia e një pakice kombëtare, që të vijohet më pas me procedurat për njohjen formale me ligj të kësaj pakice.

Komisioni për të kryer funksionin e tij, do të mbështetet nga një Sekretariat Teknik, ngritja dhe funksionimi i të cilit, do të përcaktohet me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar për miratim është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është hartuar në zbatim të nenit 100, të saj dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Projektvendimi është në harmoni me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, të ratifikuar me ligjin nr. 8496, datë 3.6.1999 dhe nuk bie ndesh me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, në fushën e të drejtave të njeriut.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”, përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) pika.

Në pikën e parë, të projektvendimit, parashikohet kërkesa për njohjen e pakicave, e cila depozitohet pranë Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen formale të pakicës kombëtare. Kjo kërkesë duhet të paraqitet nga një grup shtetasish prej jo më pak se 300 (treqind) persona me zotësi të plotë për të vepruar, që pretendojnë se i përkasin pakicës kombëtare.

Në pikën e dytë, të projektvendimit, përcaktohet që Komisioni ngrihet me urdhër të Kryeministrit, për shkak të institucioneve të përfaqësuara në të, si dhe përcaktohet përbërja e Komisionit, duke siguruar përfaqësimin në këtë komision të strukturave përgjegjëse brenda Ministrisë së Brendshme dhe të institucioneve të tjera, fusha e përgjegjësisë së të cilave, është e lidhur me atë të pakicave kombëtare, si përsa i përket trajtimit të tyre, por dhe të dokumentacionit që trajtojnë apo kanë në administrim.

Në pikën e tretë, të projektvendimit, është përcaktuar niveli i përfaqësimit në komision.

Në pikën e katërt dhe të pestë, të projektvendimit, përcaktohet kompetenca e komisionit për të shqyrtuar kërkesën dhe për të verifikuar plotësimin e kriterëve ligjore, nëpërmjet bashkëpunimit me të gjitha institucionet publike në nivel qendror sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”. Kriteret ligjore janë ato të përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa dokumentacioni është ai i përcaktuar në nenet 6 dhe 7, të po këtij ligji.

Në pikën gjashtë, të projektvendimit, është përcaktuar procedura dhe afatet për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur. Kështu, kur gjatë shqyrtimit të kërkesës, Komisioni konstaton se ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur kërkon nga grupi i shtetasve që ka paraqitur kërkesën apo përfaqësuesi i autorizuar i tyre, plotësimin e dokumentacionit brenda 15 ditëve. Me përfundimin e këtij afati, Komisioni mblidhet dhe merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të tij brenda 30 ditëve.

Në pikën shtatë, të projektvendimit është parashikuar afati kur komisioni merr vendim nëse procedura dhe paraqitja e kërkesës është e regullt, pa mangësi.

Në pikën tetë, të projektvendimit, përcaktohet se vendimi i Komisionit arsyetohet dhe i komunikohet grupit të shtetasve apo përfaqësuesit të tij në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, është përcaktuar e drejta e ankimit kundër vendimit të Komisionit për refuzimin e kërkesës për njohje të pakicës kombëtare, e cila mund të bëhet pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

Në pikën nëntë, të projektvendimit, është parashikuar kompetenca e Komisionit që në rast se pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur identifikohet (vërtetohet) përkatësia e një pakice kombëtare dhe plotësohen kriteret ligjore, të përcaktuara në nenin 3, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të vendosë pranimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare dhe t’i paraqesë Ministrit të Brendshëm, propozimin me relacionin e argumentuar për vijimin e procedurave për njohjen formale të pakicës kombëtare.

Në pikën dhjetë, të projektvendimit, parashikohet kompetenca e Ministrisë së Brendshme, që në bazë të vendimit dhe relacionit të argumentuar të hartojë projektaktin normativ për njohjen formale të pakicës kombëtare dhe t’ia paraqesë Këshillit të Ministrave, me qëllim propozimin nga ky institucion të projektligjit në Kuvend, si iniciativë e Këshillit të Ministrave.

Në pikën njëmbëdhjetë të projektvendimit, përcaktohet se veprimtaria e Komisionit mbështetet nga një Sekretariat Teknik, ngritja dhe funksionimi i të cilit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

Në pikën dymbëdhjetë është përcaktuar si institucion i përcaktuar për zbatimin e këtij projektvendimi, Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi janë Ministria e Brendshme dhe institucionet në përbërje të Komisionit, të përcaktuara në pikën 2 të projektvendimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Brendshme.

Me shkresën nr. 2130/3 Prot., datë 5.10.2018, ky projektvendim dhe relacioni shpjegues, i janë dërguar për mendim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Kulturës, Komitetit Shtetëror të Pakicave Kombëtare, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Akademisë së Shkencave dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Janë shprehur dakord Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Instituti i Historisë, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, me shkresën nr. 43 Prot., datë 24.10.2019, është shprehur "... e konsiderojmë të panevojshme, madje ndoshta edhe të dëmshme për interesat kombëtare, ngritjen e një komisioni të tillë për të diskutuar rreth ekzistencës së pakicave të tjera kombëtare në Shqipëri".

Duke qenë se vlerësojmë që ky sugjerim është i lidhur me njohjen e pakicave kombëtare, gjë që është bërë me ligjin nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", ndërsa projektvendimi është një projektakt nënligjor, propozimi dhe miratimi i të cilit është detyrim ligjor, ky sugjerim nuk është reflektuar.

Mendimi i **Akademisë së Shkencave** është reflektuar, duke shtuar në projektvendim, si anëtar të Komisionit edhe një përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

Mendimi i **Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë**, i dërguar me shkresën nr. 17694/1 Prot., datë 25.10.2018, në lidhje me përcaktimin qartë në relacionin shpjegues të projektvendimit, që shpërblimi i anëtarëve të komisionit të përcaktohet në përputhje me nenin 4, pika 3, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", është reflektuar.

Në lidhje me sugjerimet e **Ministrisë së Drejtësisë**, të dërguar me shkresën nr. 10140/1 Prot., datë 12.10.2019, shpjegojmë si vijon:

- Sugjerimi parë, i lidhur me zëvendësimin e fjalës “përbërjes”, me fjalën “strukturës”, nuk është reflektuar, pasi qëllimi i projektvendimit është të përcaktojë përbërjen e komisionit dhe jo strukturën e tij, pasi në përputhje me ligjin nr.90/2012, struktura miratohet me urdhër të Kryeministrit, ndërkohë që komisioni është një organizëm ad hoc dhe jo një person juridik me një strukturë të mirëfilltë organike. Në këtë rast përcaktohet përbërja e tij, me përfaqësues të institucioneve, fusha e përgjegjësisë apo veprimtarisë së të cilave, është e lidhur me të drejtat e njeriut, në veçanti me të drejtat e pakicave kombëtare.
- Sugjerimet 2, 3, 4 dhe 5, janë reflektuar.

Për sugjerimin e gjashtë, në lidhje me argumentimin në mënyrë të detajuar të kushteve ligjore dhe dokumentacionit të nevojshëm që duhet paraqitur nga kërkuesit, shpjegojmë se kriteret janë përcaktuar në ligj dhe dokumentacioni është përcaktuar në një tjetër projektakt nënligjor, që do të nxirret në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, projektvendimit “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”. Kështu në nenin 4, të ligjit, përcaktohet se: “Njohja formale e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, përveç atyre të parashikuara në nenin 3, pika 2, bëhet me ligj, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, dhe nenet 6 e 7 të këtij ligji.” Megjithatë ky formulim është bërë pjesë e projektvendimit.

Në lidhje me sugjerimet e **Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme**, të dërguara me shkresën nr. 3370 Prot., datë 6.3.2019, shpjegojmë si vijon:

- Sugjerimi i parë është reflektuar.
- Sugjerimi i dhënë për pikën 2, të projektvendimit, për përfshirjen e një përfaqësuesi i ME&PJ, është reflektuar. Ky sugjerim është dhënë edhe nga Akademia e Shkencave.
- Sugjerimi për të shtuar një pikë për përcaktimin e numrit të personave që do të paraqesin kërkesë për njohje formale të pakicës, është reflektuar.

- Në lidhje me sugjerimin se çfarë duhet të përmbajë kërkesa për njohje formale, si dhe dokumentet shoqëruese, duke iu referuar elementëve të parashikuar në pikën 1, të nenit 3, nenit 6 dhe nenit 7 të ligjit, vlerësojmë se nuk nevojitet një përcaktim mbi kërkesën dhe dokumentacionin, për sa kohë ligji autorizon ngritjen, funksionimin, përbërjen dhe procedurën e komisionit dhe jo të dokumentacionit. Shpjegojmë se nuk do të ketë formular të veçantë, për sa kohë dokumentacioni/formulari do të propozohet në zbatim të nenit 7, të ligjit.
- Sugjerimi i bërë në lidhje me paraqitjen e kërkesës për njohje formale në një pakicë kombëtare, sipas nenit 2, pika 4, vlerësojmë se është i panevojshëm, për sa kohë është një parashikim ligjor dhe parashikimi edhe në projektvendim do të përbënte përsëritje dhe nuk ka ndonjë vlerë të shtuar.
- Sugjerimi i dhënë për pikën 6, në lidhje me heqjen e termit “grupi i shtetasve”, nuk është reflektuar, për sa kohë në këtë pikë është parashikuar edhe përfaqësuesi i autorizuar i grupit të shtetasve.
- Sugjerimi i dhënë për pikën 8, është reflektuar pjesërisht, pa përsëritur dispozitën ligjore.
- Sugjerimi i dhënë për pikën 9, nuk është reflektuar, pasi bie ndesh me nismën ligore sipas parashikimeve kushtetuese, ku të drejtën për të propozuar pojektligje e kanë Këshilli i Ministrave, çdo deputet dhe 20.000 zgjedhës. Në këto kushte, Ministria e Brendshme propozon në Këshillin e Ministrave, projektvendimin për propozimin e projektligjit. Ky i fundit do të propozohet në Kuvend nga Këshilli i Ministrave.

Projektvendimi është dërguar për bashkërendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komitetit Shtetëror të Pakicave Kombëtare, të cilët kanë konkluduar si më poshtë vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 2866/1 Prot, datë 14.02.2020, është shprehur parimisht dakord.

Në lidhje me sugjerimet e **Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme**, të ardhura me shkresën nr. 4102 Prot., datë 11.03.2020, shpjegojmë si vijon:

- Në lidhje me sugjerimin e parë, është reflektuar pjesërisht duke u bërë riformulimi i pikës 1 në mënyrë që të jetë më e qartë dhe jo konfuzuese.
- Sugjerimi i dytë, në lidhje me parashikimin në projektvendim të paraqitjes e kërkesës për njohje formale në një pakicë kombëtare, sipas nenit 2, pika 4, të ligjit nr. 96/2017, është tashmë e sanksionuar në ligj dhe e vlerësojmë të panevojshëm, pasi vetëm thjesht do përbënte përsëritje dhe nuk do të kishte ndonjë vlerë të shtuar.
- Në lidhje me sugjerimin e tretë, për të referuar pikën 1 të nenit 4 të ligjit për pakicat kombëtare, nuk është reflektuar, duke ritheksuar që pakicat e deklaruara në pikën 2 të nenit 3 janë tashmë të njohura ndaj kërkesa paraqitet vetëm për ato që duan të njihen si pakicë, duke plotësuar edhe kushtet e sanksionuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Përsëritja e ligjit nuk është e nevojshme, pasi është e dukshme dhe i qartë qëllimi i kërkesës.
- Në lidhje me sugjerimin e katër dhe pestë, nuk është reflektuar pasi vlerësojmë se nuk nevojitet një përcaktim apo kriter mbi përmbajtjen e kërkesës apo dokumentacionin që duhet të paraqitur nga shtetasit sipas pretendimeve të ngritura pasi kjo do realizohet dhe do propozohet si projektvendim i veçantë detyrim i nenit 7 të ligjit 96/2017, si dhe për sa kohë qëllimi i këtij projektvendimi bazuar në autorizimin ligjor është ngritja, funksionimi, përbërja dhe procedurën e komisionit dhe jo të dokumentacionit.
- Lidhur me sugjerimin e emërtesat e institucioneve bazuar në fushat e përgjegjësi të ministrive, është reflektuar.
- Në lidhje me sugjerimin e hartimit të aktit normativ nga ministria e brendshme është reflektuar, duke e zëvendësuar me “projektaktin ligjor”.

Në lidhje me sugjerimet e **Ministrisë së Drejtësisë** të ardhura me shkresën nr. 921/1 Prot., datë 19.02.2020, janë reflektuar pjesërisht, konkretisht, shpjegojmë si vijon:

- Sugjerimi i bërë në pikën 1 të projektvendimit në lidhje me riformulimin e saj, për konfuzionin midis autoritetit që vendos ngritjen e Komisionit Këshilli i Ministrave apo Kryeministri është reflektuar.

- Në lidhje me sugjerimin 2.2 për përcaktimin e nivelit të përfaqësuesve është reflektuar duke sanksionuar nivelin e “lartë” drejtues.
- Sugjerimi për riformulimin e titullit të projektvendimit, nuk është reflektuar pasi qëllimi i projektvendimit është të përcaktojë përbërjen e komisionit, cilat janë funksionet dhe çfarë procedure ndjek. Në këtë rast përcaktohet përbërja e tij, me përfaqësues të institucioneve, fusha e përgjegjësisë apo veprimtarisë së të cilave, është e lidhur me të drejtat e njeriut, në veçanti me të drejtat e pakicave kombëtare. Gjithashtu evidentimi se komisioni është ad hoc nuk është e nevojshme pasi vetë ligji për mbrojtjen e pakicave kombëtare e sanksionon të tillë.
- Në lidhje me sugjerimin e dhënë në pikat 3.2, 3.3 dhe 3.4 janë reflektuar terësisht.

Në lidhje me sugjerimet e **Avokatit të Popullit** të ardhura me shkresën nr. 71/1 Prot., datë 05.03.2020 të protokolluar nga institucioni ynë në datë 24.03.2020 1004/5 janë reflektuar pjesërisht, konkretisht, shpjegojmë si vijon:

- Në lidhje me sugjerimin për ndryshimin e tofjalëshit grup shtetasish, arsyetojmë se nuk është e nevojshme pasi vet ligji për mbrojtjen e pakicave e parashikon në nenin 3 të tij dhe projektvendimi e bën të qartë se shtetasit janë shqiptarë.
- Në lidhje me sugjerimin e dytë evidentojmë se parashikimi i një grupi shtetasish prej 300 personash është bazuar duke pasur si referenca numrin e krijimit të organizatave kulturore, sociale, politike, por ky fakt është vendosur gjithashtu në mbledhjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës ku antarë ka qenë edhe Avokati i Popullit dhe janë dakordësuar për sanksionimin e numrit prej 300 personash.
- Referuar sugjerimit të tretë nuk është reflektuar, pasi sipas përkufizimit të ligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare parashikohet se: *“Pakica kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika të dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale.....”*, pra përfshirja e lidhjes gjuhësore në definicionin se çfarë do konsiderojmë pakicë është mjaft e qartë ndaj procedura e ndjekur do jetë e njëjta nëse përmbushen kushtet e vendosura në aktet ligjore dhe nënligjore, ku më pas drejtohen me kërkesë të

Komisionin e posaçëm. Si përfundim konkludojmë se është e panevojshme dhe jo e arsyeshme specifikimi i saj.

- Në lidhje me sugjerimin e katër, për vendosjen e kritereve të detajuara nuk është reflektuar sepse vlerësojmë se nuk është e nevojshme pasi kjo do realizohet dhe do propozohet si projektvendim i veçantë detyrim i nenit 7 të ligjit 96/2017, si dhe për sa kohë qëllimi i këtij projektvendimi bazuar në autorizimin ligjor është ngritja, funksionimi, përbërja dhe procedurën e komisionit dhe jo të dokumentacionit.

Referuar pyetjes për standardin referues për përcaktimin e mangësive të kërkesës që konstatohet nga Komisioni, referojmë se është neni 3 i parashikuar i ligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe përcaktimi i bërë në nenin 7 i ligjit nr. 96/2017. Gjithashtu, ligji autorizon ngritjen, funksionimin, përbërjen dhe procedurën e komisionit dhe jo të dokumentacionit. Shpjegojmë se nuk do të ketë formular të veçantë, për sa kohë dokumentacioni/formulari do të propozohet në zbatim të nenit 7, të ligjit.

- Sugjerimi i dhënë në pikën 3 është reflektuar.

Nisur nga fakti që ka patur sugjerime nga institucionet ku është ridërguar për bashkëpunim projektvendimi, i ridërgohet edhe një herë për mendim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komitetit Shtetëror të Pakicave Kombëtare, projektvendimi i ripunuar bazuar në sugjerimet e tyre.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk ka efekte financiare.

PROPOZUESI

MINISTRI

SANDËR LLESHAJ

Znj. Romina KUKO, Zëvendësministër i Brendshëm.

Z. Plarent NDRECA, Sekretar i Përgjithshëm.

Znj. Silvana BANUSHI, Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike.

Z. Bledar DORACAJ, Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile

Znj. Dorela KARARAJ, Specialiste e Sektorit të Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore.